

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**AUTORITETIN RRUGORE SHOIPTAR (ARRSH), PER PROJEKTIN “NDËRTIM**  
**BY PASS DURRËS DHE NYJE E VORËS”.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ArrSH pr projektin “Ndertimi by pass Durres dhe nyja e Vores”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga fillimi i projektit deri më date 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 61/54 prot, datë 27.04.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për oraganizimin dhe funksionimi e Kontrollit te Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 61/6, datë 27.04.2015 dërguar Z. Dashamir Xhika, Drejtor i Përgjithshëm ARrSH, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Projekti nuk ka arritur të përfundojë sipas parashikimeve brenda vitit 2010, kryesisht nga vonesat në procesin e shpronësimeve. ARrSH/NJZP dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, kanë kërkuar shtyrjen e përfundimit të projektit deri në fund të vitit 2015, afat i cili është miratuar (trajtuar më hollësisht në faqen 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*ARrSH dhe MTI të marrin masa për të përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet e Marrëveshjeve të lidhura për financimin e projekteve me investime të huaja, me qëllim përmbushjen e detyrimeve mbi sigurimin e tokës apo të drejtat për sa i përket tokës që është e nevojshme për zbatimin e Projekteve, si edhe të përfundojë punimet e pa kryera dhe disbursimet brenda afateve të përcaktuara.*

*Vazhdimisht*

2. Nuk është arritur që të kryhet procesi i shpronësimit brenda afatit të përcaktuar në Marrëveshjen e Huas, kjo për arsye të mungesës së fondeve, si dhe të praktikave të shpronësimeve në proces, veprime në kundërshtim me pikën 4.08 të Marrëveshjes së huas e ratifikuar me ligjin nr. 9921, datë 26.05.2008.

Vlera e përgjithshme e shpronësimeve për këtë projekt, e përcaktuar sipas VKM-ve, është 515,394,289 lekë, dhe janë paguar 378,107,824 lekë, ose 73 % e shumës (trajtuar më hollësisht në faqen 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*MTI, ARrSH dhe Ministria e Financave të marrin masa për të përfunduar procesin e shpronësimeve dhe likuidimin e shumës së mbetur prej 137,286,465 lekë, ndaj pronarëve të tokës.*

*Brenda muajit Shtator 2015*

3. Për projektin “Mbikalimi i Durrësit dhe nyja rrugore e Vorës”, mungon studimi fizibilitetit, si dhe Dokumenti i Vlerësimit të Projektit (PAD), ku përcaktohen paraprakisht

se sa është kosto totale e projektit, si dhe përfitimet, matja e arritjeve të pritshme me përfundimin e projektit (trajtuar më hollësisht në faqet 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***NJZP dhe ARrSH, të marrin masa që në të ardhmen të sigurojnë dhe të plotësojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për projektet, duke filluar me dokumentet e fazës fillestare studimi i fizibilitetit, Dokumentet Vlerësuese deri me dokumentet e mbylljes së projekteve.***

***Vazhdimisht***

4. Disbursimi i Huas nuk ka ecur me ritme konstante dhe normale. Huamarrësi nuk ka përmbushur detyrimin e Marrëveshjes së Huas, për sigurimin e tokës dhe të drejtave mbi të, duke sjellë vonesa në realizimin e punimeve e për pasojë dy shtesa në kontratën e konsulentit, në shumën 274,660 Euro (trajtuar më hollësisht në faqen 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***ARrSH dhe NJZP të marrin masa që në të ardhmen të realizojnë projektet e financuara nga donatorë të huaj, brenda afateve të përcaktuara në Marrëveshjet financiare, pasi shtyrja e afateve ka sjellë shtesa në kontratat e konsulencës/mbikëqyrjes, duke shkaktuar rritje të koston së projektit.***

***Vazhdimisht***

5. Për segmentin rrugor Shkozet - Plepa ishte parashikuar që krahas 4 korsive 2 vajtje dhe 2 ardhje, të ndërtoheshin edhe dy rrugët anësore të shërbimit, për të cilat është vendosur nga strukturat përkatëse Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar si dhe Fondi Kuvajtian, për mos realizimin e tyre. Arsyeja e heqjes së rrugëve paralele është minimizimi i koston së lartë të shpronësimit të objekteve dhe truallit. Ndikim në këtë vendim ka patur parashikimi i ndërtimit të rrugës Thumanë-Rrogzhinë, i cili mund të lehtësonte trafikun në këtë segment rrugor, investim i cili nuk është realizuar në fakt (trajtuar më hollësisht në faqet 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masat e duhura për realizimin e studimeve të fizibilitetit duke përzgjedhur variantet me të leverdishme por edhe më funksionale në shërbim të transportit rrugor. Duhet të bëhet një harmonizim i fizibilitetit të projekteve rrugore për të arritur në zgjidhje optimale dhe afatgjata.***

***Vazhdimisht***

6. Gjatë zbatimit të kontratave të mbikalimit të Vorës dhe By-Pass Durrës, janë miratuar ndryshime të shumta të cilat kanë ardhur edhe si pasojë e realizimit pa cilësi të projekteve të zbatimit (trajtuar më hollësisht në faqen 32-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masat e duhura dhe të kërkojë nga konsulentët aplikimin e standardeve më të mira për realizimin e veprave publike, duke rritur rolin monitorues edhe nëpërmjet vendimmarrjes në Këshillin Teknik.***

***Vazhdimisht***

7. Në mbikalimin e Vorës ka dëmtime të disa elementëve përbërës rrugor, si rrethimet mbrojtëse apo parmacë, për të cilat nuk janë marrë masat e duhura për riparimin e tyre (trajtuar më hollësisht në faqen 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***T'i kërkohet kontraktorit riparimi i parmacëve të dëmtuar dhe zëvendësimi në ato vende ku janë hequr, me synim parandalimin e aksidenteve.***

***Menjëherë***

8. Rrethrotullimet e mbikalimit të Vorës nuk janë lidhur përfundimisht me Qytetin e Vorës, kjo për arsye se nuk është bërë e mundur hapja e një segmenti rreth 150 ml, i cili kalon në një pronë private (trajtuar më hollësisht në faqen 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***ARrSH dhe Njësia e Zbatimit të Projektit, të marrin masa për realizimin e lidhjes së rrethrotullimeve me Qytetin e Vorës dhe Superstradën Tiranë-Durrës, për vënien në eficiencë të plotë të këtij investimi.***

***Brenda muajit qershor 2015***

9. Punimet e kontratës së ndërtimit të By-Pass Durrës, kanë filluar me datë 15.06.2009 dhe afati për përfundimin e tyre ishte data 05.04.2011, është miratuar shtesa e afatit të përfundimit të punimeve përkatësisht me 1840 ditë, duke parashikuar përfundimin e tyre me datë 30.03.2015. Arsyeja e shtesës ka të bëjë kryesisht me pamundësinë e ARrSH për të siguruar aksin në gjithë segmentet rrugore për zbatimin e punimeve nga Kontraktori (trajtuar më hollësisht në faqen 32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masat e duhura që për projektet me financime të huaja në vazhdim, të kërkojë nga njësitë e zbatimit të projekteve dhe konsulentët të rrisin monitorimin e kontratave dhe të marrin masat e duhura për problematikat që ndikojnë në ndërprerje apo pezullim të punimeve, me synim përfundimin dhe vënien në eficiencë të investimeve sipas parashikimeve në marrëveshjet e financimit.***

***Vazhdimisht***

10. Gjatë zbatimit të kontratës së ndërtimit të Nyjes së Vorës janë realizuar 32 pagesa të ndërmjetme. Nga këto, 21 pagesa janë likuiduar me vlerë më të vogël se limiti i përcaktuar në kontratë, në shumën 150,000 Euro. Ky veprim bie në kundërshtim me pikën 14.6 të kushteve të veçanta të kontratës "Vlera minimale e certifikatave të pagesave ndërmjetëse" (trajtuar më hollësisht në faqen 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Konsulenti, të marrin masa dhe mos të pranojnë nga kontraktorët certifikata punimesh me vlerë nën limitin e përcaktuar në kontratë.***

***Vazhdimisht***

11. Referuar punimeve të realizuara sipas urdhër ndryshimit nr. 3, (rruga e KIA-s) rezulton se, segmenti rrugor i ndërtuar ka pësuar dëmtime të shumta. Shtresat rrugore janë dëmtuar, duke u bërë shkak për aksidente. Cilësia e punimeve të këtij segmenti rrugor si edhe dëmtimet e shumta në një kohë shumë të shkurtër nga vënia në funksionim, tregojnë për punime të realizuara pa respektuar standardet dhe specifikimet teknike si për realizimin e

ngjeshjes së shtresave rrugore, ashtu edhe për përmbajtjen e materialeve përbërëse të tyre (trajtuar më hollësisht në faqen 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Konsulenti të njoftojnë dhe të kërkojnë nga Kontraktori ....., riparimin e defekteve në segmentin rrugor “Rrugë e KIA-s–Karburant Kastrati”, si dhe garantimin e qëndrueshmërisë së punimeve të realizuara.*

*Menjëherë*

**12.** Referuar punimeve të kryera në rrugët e aksesit të mbikalimit të Vorës, shtresat rrugore janë ndërtuar me ndërprerje të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e punimeve (trajtuar më hollësisht në faqen 28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa dhe të monitorojnë sipas përcaktimeve kontraktore zbatimin e kushteve teknike, me qëllim arritjen e cilësisë së kërkuar të punimeve.*

*Vazhdimisht*

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1.** Referuar skicave përfundimtare për segmentin rrugor nga kilometri 3.850 deri në kilometrin 4.100, ka mbivendosje për distancën 75 ml, duke llogaritur dy herë si ndërtim gjatësinë e rrugës. Vlera prej 7,200 Euro është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ..... dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqen 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Njësia e zbatimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa që në situacionin përfundimtar të zbresin vlerën 7,200 Euro, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ....., për punime të pa realizuara.*

*Gjatë hartimit të situacionit përfundimtar*

**2.** Në librezën e masave sipas zërit “Furnizim vendosje bordura” është përshkruar realizimi i 8,412.6 ml bordura, ndërsa nga verifikimi i dokumentacionit të certifikimit dhe likuidimit rezulton se sipas pikës R. 6.1 është përfshirë sasia 9,300 ml. Vlera 7,454.16 Euro [(9300 ml - 8412.6 ml) x 7 Euro/ml + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ..... dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Njësia e zbatimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa që në situacionin përfundimtar të zbresin vlerën 7,454.16 Euro, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ....., për punime të pa realizuara.*

*Gjatë hartimit të situacionit përfundimtar*

3. Në lidhje me realizimin e shtresave asfaltike, nga verifikimi në objekt rezulton se nuk është realizuar sasia 845 m<sup>2</sup>, ndërkohë që është raportuar si e realizuar. Kjo sasi nuk është realizuar në rrugën e aksesit në gjatësinë 100 m (nga kilometër 0.100 deri kilometër 0.150). Vlera 10,849 Euro (9,041 Euro + TVSH), përbën pagesë për punime të pa realizuara (trajtuar më hollësisht në faqet 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***Njësia e zbatimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa që në situacionin përfundimtar të zbresin vlerën 10,849 Euro, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori ....., për punime të pa realizuara.***

***Gjatë hartimit të situacionit përfundimtar***

4. Referuar punimeve të realizuara në lidhje me ndërtimin e murit mbajtës prej gabioni në gjatësinë 64 m, rezulton se punimet janë bërë të padukshme në thellësi të murit. Murit nuk i është ndërtuar kokë prej betoni, ndërsa në dokumentet e certifikimit të punimeve rezulton e përfshirë sasia 43.2 m<sup>3</sup> beton me vlerë 2,937.6 Euro, e cila përbën certifikim të punimeve të pa realizuara (trajtuar më hollësisht në faqet 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

***Njësia e zbatimit të Projektit dhe Konsulenti të marrin masa për korrigjimin e librit të masave dhe të reflektohet në situacionit e punimeve të kontratës “Ndërtim i Njës së Vorës”, sa i përket sasisë së betonit të certifikuar në sasinë 43.2 m<sup>3</sup>, me vlerë 2,937.6 Euro, përfituar padrejtësisht nga Kontraktori .....***

***Menjëherë***

*Shënim:* Auditimi u krye nga audituesit Artan Topjana, Mimoza Bedini dhe Jorida Zhegu, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Ilizai, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.